

Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave, shpall konkursin për 1 (një) vend të lirë pune për Kryesekretare Mësimore.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere:

- a) Të ketë mbaruar Master Shkencor, në një nga programet e studimit të Universitetit të Tiranës, në shkencat shoqërore;
- b) Të njohë Kornizën Shqiptare të Kualifikimit, në kuadër të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit;
- c) Të ketë mbrojtur një gjuhë të huaj të Bashkimit Europian;
- d) Të njohë programet bazë të kompjuterit;
- e) Të ketë aftësi menaxhuese dhe të punës në grup.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë duhet të paraqesin brenda datës **18.12.2020** pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Curriculum Vitae;
3. Diploma e studimeve universitare dhe lista e notave të noterizuara. (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
4. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
5. Kopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Certifikatë kualifikimi dhe trajnimesh të ndryshme (në rast se ka);
7. Dëshmi e gjuhës së huaj e noterizuar;
8. Raport mjekësor për aftësi në punë;
9. Dëshmi penaliteti ose formular vetëdeklarimi.